



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

FORMULAR I
KËRKESËS INDIVIDUALE
(KI)¹

për

parashtrimin e kërkesës individuale në bazë të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të neneve: 46 (Lejueshmëria), 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës), 49 (Afatet) dhe 50 (Kthimi në gjendje të mëparshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

në

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Vërejtje nga Gjykata: Bazuar në Rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Nr. 01/2023, lidhur me kërkesat e dorëzuara sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës duhet të përdoret ky Formular i kërkesës ose ekuivalenti i formularit të kërkesës (*ekuivalenti i formularit të kërkesës duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe të plotësohet sipas të gjitha kritereve që kërkohen në këtë Formular*). Ky formular mund të plotësohet me dorë ose në formë elektronike, përmes kompjuterit.

Për informata shtesë lidhur me plotësimin e kërkesës mund t'i referoheni "Udhëzuesit për parashtrimin e kërkesave individuale (KI)" të publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

¹ Informatat e kërkuara në këtë Formular nuk paragjykojnë në asnjë mënyrë çështjen e pranueshmërisë apo meritave të kërkesës të përcaktuar në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës dhe/ose rezultatit e vendimmarrjes së Gjykatës.

I. PALA/PALËT QË PARASHTROJNË KËRKESË

Ju lutemi plotësoni të dhënat në rubrikat e mëposhtme:

- Nëse parashtroni kërkesë në cilësi të individit (personit fizik), luteni të plotësoni rubrikën “A”².
- Nëse parashtroni kërkesë në cilësi të personit juridik (p.sh. kompani biznesi), luteni të plotësoni rubrikën “B”.
- Nëse jeni të përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar nga ju, luteni të plotësoni të dhënat në rubrikën “C”.
- Gjithashtu, luteni të plotësoni të dhënat në rubrikat “Pala kundërshtare” dhe “Akti i kontestuar” në rubrikën “D”.
- Nëse në çështjen tuaj ka një palë të interesuar, që afektohet nga vendimmarrja, luteni të plotësoni të dhënat në rubrikën “E”.

A. Parashtruesi i kërkesës - Individ (Person fizik)

1. Emri dhe Mbiemri

2. Data e lindjes

3. Vendlindja

4. Gjinia

Mashkullore

Femërore

5. Profesioni

6. Adresa

7. Numri kontaktues i telefonit

8. E-mail:

B. Parashtruesi i kërkesës - Subjekti (Person juridik)

1. Emërtimi

2. Data e regjistrimit/themelimit

3. Numri i identifikimit

4. Statusi

OJQ BI SHPK SHA

ose tjetër (shëno)

5. Fushë-veprimtaria

6. Adresa

7. Numri kontaktues i telefonit

8. E-mail:

² Nëse kërkesa parashtrohet nga më tepër se një parashtrues me të njëjtin akt të kontestuar dhe me pretendime të njëjta, faqja 2 e formularit plotësohet për secilin prej parashtruesve të kërkesës.

C. Përfaqësuesi

9. Emri dhe Mbiemri	
10. Profesioni	
11. Shoqata (nëse ka)	
12. Adresa	
13. Numri i telefonit	
14. E-mail	

D. Pala kundërshtare

15. Emri i autoritetit/gjykatës	
16. Adresa	
17. Numri i telefonit	
18. E-mail	
19. Akti i kontestuar	
20. Data e pranimit të aktit të kontestuar	
21. Vendimi i fundit për rastin tuaj (nëse është i ndryshëm nga pika 19) dhe data e pranimit të tij	

E. Pala e interesuar (nëse ka)


22. Emri dhe Mbiemri	
23. Adresa	
24. Numri i telefonit	
25. E-mail	


II. PËRSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I FAKTEVE

Ju lutemi jepni hollësi të qarta dhe koncize për faktet që ngërthen kërkesa e juaj, duke i përshkruar në mënyrë kronologjike procedurat e ndjekura pranë autoriteteve publike. Nëse ankesat tuaja kanë të bëjnë me një numër çështjesh (për shembull, disa procedura, administrative, gjyqësore, etj.), ju lutemi ta trajtoni secilën çështje ndaras.

Vërejtje nga Gjykata: Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me faktet që ndërlidhen me këtë kërkesë duhet të përmbliken në këtë pjesë të formularit, **në më së shumti tri (3) faqe**.

Nuk është e pranueshme që kjo rubrikë të lihet e zbrazët duke iu referuar sqarimeve të paraqitura në dokumente shtesë. Gjithashtu, nuk është e pranueshme që kjo rubrikë të adresojë vetëm një pjesë të fakteve ndërsa për pjesën tjetër t'i referoheni dokumenteve shtesë. Përderisa sqarime shtesë mund të bashkëngjiten, Gjykata duhet të jetë në gjendje të kuptojë faktet relevante të kërkesës në tërësi përmes kësaj rubrike, pa pasur nevojë për plotësime shtesë.





III. SHKELJET E PRETENDUARA

Ju lutemi saktësoni nenin e Kushtetutës apo të Konventave dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës sipas nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, që pretendoni se është cenuar nga autoriteti përkatës publik apo gjykata, duke i'u referuar aktit të autoritetit përkatës publik apo vendimit të gjykatës.

Vërejtje nga Gjykata: Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me pretendimet që ndërlidhen me këtë kërkesë duhet të përmbliken në këtë pjesë të formularit, **në më së shumti shtatë (7) faqe**. Nuk është e pranueshme që kjo rubrikë të lihet e zbrazët duke iu referuar pretendimeve të paraqitura në dokumente shtesë. Gjithashtu, nuk është e pranueshme që në këtë rubrikë t'i referoheni vetëm një pjese të pretendimeve, ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve t'i referoheni dokumenteve shtesë. Përderisa sqarime shtesë mund të bashkëngjiten, Gjykata duhet të jetë në gjendje të kuptojë pretendimet tuaja për shkelje kushtetuese lidhur me këtë kërkesë përmes kësaj rubrike, pa pasur nevojë për plotësime shtesë.

Gjithashtu, pretendimet e juaja për shkelje kushtetuese, duhet t'iu referohen neneve specifike kushtetuese që pretendohet se janë shkelur, si dhe të sqarohen pretendimet për shkelje të tyre.

<p>Neni i shkelur i Kushtetutës dhe/ose Konventave apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës</p>	<p>Arsyetimi se si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e pretenduar e nenit apo e dispozitës përkatëse të Kushtetutës apo Konventave apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës sipas Kushtetutës.</p>

--	--

--	--

--	--

--	--

--	--

--	--

IV. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE

Vërejtje nga Gjykata: Parashtruesit e kërkesave duhet të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion sipas ligjit, para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Nëse pretendoni se keni pasur një mjet juridik në dispozicion, sipas ligjeve në fuqi, por që nuk e keni shteruar, luteni që të shpjegoni arsyet e mosshterimit të atij mjete juridik.

V. PARAQITJA E KËRKESËS BRENDË AFATIT TË PËRCAKTUAR KATËR (4) MUJOR

Vërejtje nga Gjykata: Parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin kërkesat e tyre brenda (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi i fundit gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse nuk keni paraqitur kërkesën tuaj brenda afatit 4 (katër) mujor dhe nëse kërkonit kthim në gjendje të mëparshme, sipas nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, luteni që të shpjegoni arsyet për një kërkesë të tillë.

VI. DOKUMENTACIONI DHE INFORMATAT PËRCJELLËSE

Ju lutemi që t'ia bashkëngjisni kërkesës tuaj të gjitha dokumentet dhe informatat relevante. Plotësoni me kujdes dhe në mënyrë kronologjike rubrikat e mëposhtme, duke shënuar, sipas datave, aktin e autoritetit përkatës; mjetin juridik të shfrytëzuar (padi, ankesë ose përgjigje); vendimet e gjykatave nga instanca më e ulët gjyqësore deri te ajo më e lartë, si dhe të gjitha dokumentet e tjera relevante.

Vërejtje nga Gjykata: Të gjitha dokumentet e shënuara në rubrikën e mëposhtme, duhet t'i bashkëngjiten kërkesës tuaj. Dokumentet e bashkëngjitura duhet të jenë kopje e origjinalit (pra, jo origjinalet), sepse ato nuk do t'ju kthehen.

Filloni nga akti përkatës, mjeti juridik i shfrytëzuar dhe vendimi i gjykatës, me radhë sipas kronologjisë.

	Emri i Dokumentit	Numri i aktit:	Data:
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			

VII. GJUHA ZYRTARE

Cila gjuhë zyrtare do të donit të përdorej në komunikim me ju?

Gjuha shqipe

Gjuha serbe

VIII. KONFIDENCIALITETI

26. Në përgjithësi, procedura në Gjykatë është publike dhe identiteti i palëve bëhet publik. Megjithatë, për arsye të veçanta, mund të kërkonti që identiteti juaj të mos zbulohet publikisht. Në këtë rast, duhet ta theksoni këtë, bashkë me arsyet e veçanta për këtë kërkesë sipas rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës. Gjykata është ajo që do të vlerësojë nëse duhet të miratohet kërkesa juaj. Megjithatë, duhet të jeni të vetëdijshëm që identiteti juaj duhet zbuluar palës së kundërshtuar. Pra, nëse dëshironi që identiteti juaj të zbulohet ose jo gjatë procedurës në Gjykatën Kushtetuese, ju lutemi, vini shenjë në kutinë përkatëse.

Të zbulohet

Të mos zbulohet

Nëse keni kërkuar që identiteti juaj të mos zbulohet, theksoni arsyet e veçanta:

IX. DEKLARIMI DHE NËNSHKRIMI

27. Deklaroj se informatat që kam dhënë në këtë formular kërkesë janë të sakta, sipas njohurisë sime dhe besimit tim.

.....

(Nënshkrimi i palës/palëve që parashtrojnë kërkesë, apo përfaqësuesit),

.....

(Vendi)

.....

(Data)

Vërejtje nga Gjykata: Nëse deklarata është nënshkruar nga përfaqësuesi, formularin e kërkesës duhet ta shoqërojë edhe një dokument i plotë i autorizimit, i nënshkruar plotfuqishëm nga pala/palët që parashtrojnë kërkesë, si dhe nga përfaqësuesi. Një mostër e dokumentit të autorizimit është bashkëngjitur te “Udhëzimi për paraqitjen e kërkesave individuale (KI)” në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që mund të gjendet në ueb-faqen e Gjykatës (www.gjk-ks.org). Kur jeni të përfaqësuar, Gjykata nuk mban korrespondencë me juve, por vetëm me përfaqësuesin tuaj.

Përfaqësuesi i një subjekti juridik (kompani, shoqatë, etj.) apo i një grupi individësh, duhet të ofrojë dëshmi të autorizimit të tij nga personi kompetent i subjektit juridik, apo nga grupi i individëve, për ta përfaqësuar atë në procedurën e Gjykatës Kushtetuese.

Ky Formular i kërkesës duhet dorëzuar në këtë adresë ose në postën elektronike (e-mail) të Gjykatës:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm

Rr. “Perandori Justinian”, nr. 44
Republika e Kosovës
10 000 Prishtinë

E-mail: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org